

REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
AKADEMIA E DREJTËSISË  
ACADEMY OF JUSTICE

Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	02	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	361
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	4	Data Datum Date	03/04/2026

Prishtinë / a

DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS

03.04.2026 DALJE - IZLAZ - PASSING

Nr/Dt No 01/210/2026

Drejtoria Qendrore - Opsia Lprava - Central Administration



## Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AKADEMISË SË DREJTËSISË

dhe

DOGANËS SË KOSOVËS

Prishtinë, Prill 2026

I. Akademia e Drejtësisë (në vijim: “AD”), e përfaqësuar nga z. Enver Fejzullahu – Drejtor Ekzekutiv, me adresë në Rr. “Murat Mehmeti” nr. 1-3, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës, email: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

në njëërën anë, dhe

II. Dogana e Kosovës (në vijim: “Dogana”), e përfaqësuar nga z. Agron Llugaliu – Drejtor Gjeneral, me adresë në Rr. “Rexhep Krasniqi”, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës, email: [Agron.Llugaliu@dogana-rks.org](mailto:Agron.Llugaliu@dogana-rks.org)

në anën tjetër,

bashkërisht të referuara si “Palët”, pajtohen të lidhin këtë:

## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi i Memorandumit**

Ky Memorandum Bashkëpunimi (në vijim: Memorandumi) ka për qëllim vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Doganës së Kosovës për mundësimin e pjesëmarrjes së zyrtarëve të Doganës së Kosovës në aktivitetet trajnuese të organizuara nga Akademia e Drejtësisë, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale dhe avancimit të njohurive në fushën e sistemit të drejtësisë, në funksion të ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare.

### **Neni 2**

#### **Fushat e Bashkëpunimit**

Përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Dogana e Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojnë në kuadër të programeve të trajnimit të organizuara nga Akademia, duke mundësuar pjesëmarrjen e zyrtarëve të Doganës në aktivitetet trajnuese në fushat me interes për institucionin.

### **Neni 3**

#### **Përgjegjësitë e Akademisë së Drejtësisë**

1. Akademia e Drejtësisë është përgjegjëse për:
  - 1.1 Organizimin e aktiviteteve trajnuese në përputhje me programet e saj trajnuese.

1.2 Sigurimin e materialeve dhe resurseve trajnuese për zyrtarët e Doganës së Kosovës që marrin pjesë në trajnim.

1.3 Informimin në kohë të Doganës së Kosovës për oraret, vendndodhjen dhe përmbajtjen e aktiviteteve trajnuese.

#### **Neni 4 Përgjegjësitë e Doganës së Kosovës**

1. Dogana e Kosovës është përgjegjëse për:

1.1 Propozimin dhe dërgimin e zyrtarëve të saj për pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë.

1.2 Sigurimin që zyrtarët e propozuar të marrin pjesë në aktivitetet trajnuese.

1.3 Bashkëpunimin me Akademinë e Drejtësisë për identifikimin e nevojave të trajnimit për stafin e saj, në përputhje me Programin e Trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë.

1.4 Dorëzimin e listës së zyrtarëve pjesëmarrës për aktivitetet trajnuese përkatëse.

#### **Neni 5 Parimet**

Palët pajtohen që në zbatimin e këtij Memorandumi të veprojnë në përputhje me parimet e transparencës, bashkëpunimit, mirëbesimit dhe respektit të ndërsjellë institucional.

#### **Neni 6 Koordinimi i Bashkëpunimit**

1. Për zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve të parapara me këtë Memorandum, palët do të caktojnë nga një person kontaktues.

2. Personat kontaktues do të jenë përgjegjës për komunikimin institucional dhe koordinimin e aktiviteteve trajnuese.

#### **Neni 7 Kohëzgjatja**

1. Ky Memorandum lidhet për një periudhë trevjeçare nga dita e hyrjes në fuqi.

2. Memorandumi mund të ndryshohet, plotësohet apo ndërpritet me marrëveshje me shkrim nga të dy palët nënshkruese.

3. Pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë, Memorandumi mund të vazhdohet me marrëveshje të ndërsjellë të palëve.

#### **Neni 8**

#### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe Ndryshimet**

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

2. Palët pajtohen që në çdo kohë mund të ndryshojnë dhe plotësojnë këtë Memorandum, në varësi të nevojave të tyre. Ndryshimet dhe plotësimet bëhen përmes plotësim-ndryshimit të këtij Memorandumi.

#### **Neni 9**

#### **Nënshkrimi i Memorandumit**


Memorandumi nënshkruhet në dy kopje të njëjta, nga një kopje për secilën palë.

#### **Neni 10**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

**Enver Fejzullahu**



Drejtor Ekzekutiv

Akademia e Drejtësisë



**Agron Llugaliu**



Drejtor Gjeneral

Dogana e Kosovës



Nënshkruar më 03/04/2026 në Prishtinë